



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 224 Prot.

Durrës, më 26.01. 2026

V E N D I M

Nr. 5, datë 26.01. 2026

PËR

"SHTYRJEN E AFATIT TË APLIKIMEVE PËR ANËTARË TË KOMISIONIT TË INTEGRITETIT AKADEMIK (KIA), NË NIVEL INSTITUCIONAL, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës".

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 46; të ligjit nr.8480, date 27.5.1999 "Për fuksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; të Urdhërit të Ministrit me Nr. 105, datë 23.03.2012 "Për miratimin e Rregullores për Etikën në veprimtarinë Kërkimore dhe Botuese"; të Statutit të UAMD-së, neni 23 pika 5; të Rregullores së UAMD-së; të Kodit të Etikës dhe të Kodit të Etikës në Kërkimin Shkencor të UAMD-së, neni 12 pika 1 dhe pika 2; të Vendimit të Senatit Akademik nr.59 datë 05.10.2023 "Mbi ngritjen e Komisionit të Integritetit Akademik (KIA), në nivel Institucional, të UAMD-së"; si dhe të Vendimit të Senatit Akademik Nr. 3, datë 13.01.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Shtyrjen e afatit të aplikimeve për anëtarë të Komisionit të Integritetit Akademik (KIA), në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, **deri me datë 05.02.2026.**
2. Kriteret dhe procedurat e aplikimit janë të përcaktuara në Vendimin Nr. 3, datë 13.01.2026 të Senatit Akademik, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit
 - Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 89/2 Prot.

Durrës, më 13.01.2026

V E N D I M

Nr. 03, datë 13.01.2026

PËR

"SHPLLJEN E APLIKIMEVE PËR ANËTARË TË KOMISIONIT TË INTEGRITETIT AKADEMIK (KIA), NË NIVEL INSTITUCIONAL, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës".

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 46; të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; të Urdhërit të Ministrit me Nr. 105, datë 23.03.2012 "Për miratimin e Rregullores për Etikën në veprimtarinë Kërkimore dhe Botuese"; të Statutit të UAMD-së, neni 23 pika 5; të Rregullores së UAMD-së; të Kodit të Etikës dhe të Kodit të Etikës në Kërkimin Shkencor të UAMD-së, neni 12 pika 1 dhe pika 2; të Vendimit të Senatit Akademik nr.59 datë 05.10.2023 "Mbi ngritjen e Komisionit të Integritetit Akademik (KIA), në nivel Institucional, të UAMD-së"; si dhe referuar njoftimit me e-mail nga Kryetarja e KIA-s, Prof.Dr. Ermira Qose, në mbledhjen e datës 13.01.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Shpalljen e aplikimeve për anëtarë të Komisionit të Integritetit Akademik (KIA), në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.
2. Kandidatët për anëtarë të Komisionit të Integritetit Akademik vetekandidohen.
3. Kandidatët për anëtarë të KIA-s, personel akademik përfaqësues të njësive kryesore që mbajnë titullin akademik "Profesor", referuar kritereve në Vendimin e Senatit Akademik nr. 59 datë 05.10.2023, duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së Senatit Akademik dokumentacionin si më poshtë:
 - Kërkesën për Kandidim (bashkëlidhur);
 - Kopje të titullit akademik;
 - Vetëdeklarimin për gjendjen gjyqësore (bashkëlidhur);
 - Kopje të dokumentit të identifikimit;
4. Kandidati nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (anëtar pa të drejtë vote), duhet të dorëzojë pranë sekretarisë së Senatit Akademik dokumentacionin si më poshtë:
 - Kërkesën për Kandidim (bashkëlidhur);
 - Vetëdeklarimin për gjendjen gjyqësore (bashkëlidhur);
 - Kopje të dokumentit të identifikimit;

5. Afati për dorëzimin e dokumentacionit është nga data 19.01.2026 deri në datën 23.01.2026, ora 9:00 - 14:00, pranë sekretarisë së Senatit Akademik, zyra 302, Currila;
6. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar, Sekretaria e Senatit Akademik pasi konfirmon të dhënat për personelin akademik që aplikon si dhe të dhënat e kandidatit nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit, përcjell listën e kandidaturave të regjistruara për votim në Senatin Akademik.
7. Për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi ngarkohen:
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit
 - Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

SEKRETARIA E SENATIT AKADEMIK

KËRKESË PËR KANDIDIM

PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË INTEGRITETIT AKADEMIK (KIA) NË UAMD

Unë i/e nënshkruar/a _____, lindur më ____/____/____, në _____, të rrethit _____, gjinia _____, staf akademik në Departamentin _____, Fakulteti _____ paraqes kërkesën time për të kandiduar për anëtar të Komisionit të Integritetit Akademik në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.

Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

- Nuk jam dënuar asnjëherë gjatë jetës time, me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë vepër penale
- Nuk kam asnjë shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 136/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"
- Nuk kam asnjë shkak për të qenë objekt i ligjit 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentat e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.
- Nuk është caktuar ndaj meje asnjë nga masat e sigurimit personal
- Nuk është dhënë ndaj meje asnjë mase disiplinore e cila është në fuqi

Kësaj kërkesë i bashkangjitet, kopja e kartës së identitetit/pasaportës, kopja e noterizuar e titullit _____ që unë zotëroj, vërtetimi i qendrës time të punës, vetëdeklarimi për integritetin e lartë akademik, vetëdeklarimi gjendjes gjyqësore.

Për sa deklaroja në këtë kërkesë mbaj përgjegjësi personale për vërtetësinë e të dhënave.

Aplikuesi

U dorëzua sot, më datën _____, në zyrën _____, tek sekretaria e Senatit Akademik _____, (firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

Dokumentacioni për kandidim:

- a) Kërkesën për kandidim, e cila përmban, emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
- c) Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- d) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- e) Kopje të noterizuar të titullit akademik;

FORMULAR VETEDEKLARIMI



Te dhënat e vetëdeklaruesit :

Mbiemri, Emri	
Atësia, Mëmësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (nje kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam :

☐ i/e padënuar ☐ i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRESI I VETEDEKLARIMIT

Emër Mbiemër / Firmë

Emër Mbiemër / Firmë

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta

dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga _____

Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

Data e nënshkrimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SEKRETARIA E SENATIT AKADEMIK



KËRKESË PËR KANDIDIM
PERSONEL NDIHMES AKADEMIK ME KARAKTER ADMINISTRATIV
PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË INTEGRITETIT AKADEMIK (KIA) NË
UAMD

Unë i/e nënshkruar/a _____, lindur
më__/_/__, në _____, ne pozicionin _____ pranë
Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, paraqes kërkesën time për të qenë anëtar
i Komisionit të Integritetit Akademik (KIA) në UAMD.

Emër, Mbiemër/ Nënshkrimi

U dorëzua sot, më datën _____, në zyrën _____, tek sekretaria e Senatit
Akademik _____, (firma)

Dokumentacioni për kandidim:

- a) Kërkesën për kandidim, e cila përmban, emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë, shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Vetëdeklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
- c) Kopje të dokumentit të identifikimit;

